

## **Fjalimi i kryetares së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, znj. Arta Rama-Hajrizi**

E nderuara Zonja Presidente e Republikës së Kosovës,  
I nderuari Kryetar i Komisionit të Venecias,  
Shkëlqesitë tuaja,  
Zonja e zotërinj,

Kam nderin dhe kënaqësinë që të hap sot ceremoninë e Vitit të Gjashtë Gjyqësor të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës. Me këtë rast, i përshëndes në mënyrë të veçantë, mysafirët tanë që kanë ardhur nga jashtë për të na nderuar dhe ju falënderoj secilin prej jush që jeni të pranishëm në këtë ngjarje. Dëshiroj të shpreh falënderimet më të sinqerta për kryetarin e respektuar të Komisionit të Venecias, zotërinë Gianni Buquicchio, që ka pranuar të jetë folës në këtë ceremoni.

Zonja dhe zotërinj, siç është zakoni, në këtë ceremoni vjetore, dëshiroj t'ju jap disa informacione rreth ngjarjeve që shënuan Vitin e kaluar Gjyqësor dhe të prezantoj disa raste të rëndësishme për të cilat ka vendosur Gjykata gjatë kësaj periudhe.

Siç jeni në dijeni, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës është gjykata më e re kushtetuese në Evropë, është themeluar 6 vjet më parë dhe që nga filltet e saj ishte e përkushtuar që të bëhet institucion i respektuar dhe i besuar nga të gjithë, duke u bazuar në parimet e sundimit të ligjit, të ndarjes së pushteteve dhe të mbrojtjes së të drejtave të njeriut.

Ky synim është ndjekur edhe gjatë viteve të kaluara gjyqësore, përkundër disa kritikave dhe përpjekjeve për të vënë në dyshim autoritetin dhe pavarësinë e Gjykatës.

Në këtë drejtim, dua të theksoj se Gjykata do të jetë e hapur dhe transparente, do të respektojë publikun dhe mediet, porse vlerësimi i kushtetutshmërisë së rasteve duhet lënë Gjykatës.

Prandaj, u bëj thirrje institucioneve që të respektojnë vendimet e Gjykatës, e cila sipas Kushtetutës së Republikës, është autoriteti përfundimtar për interpretimin e Kushtetutës dhe për vlerësimin e pajtueshmërisë së ligjeve me të. Vendimet e Gjykatës janë të arsyetuara mirë dhe ato flasin për veten.

Si çdo institucion në një demokraci të re, Gjykata Kushtetuese është duke fituar forcën dhe po ngrit performancën e saj, përkundër faktit se nuk ishte në përbërje të plotë prej 9 gjyqtarësh për më shumë se 3 vjet dhe aktualisht, në vend të 9 gjyqtarëve, Gjykata përbëhet vetëm nga 7 gjyqtarë. Procedura e rekrutimit për 2 gjyqtarët e tjerë është ende

në vazhdim e sipër. Andaj, duke pritur që ky proces të përfundojë me sukses, i bëj thirrje Kuvendit që të plotësojë vendet e lira të tanishme sa më parë që të jetë e mundur.

Zonja dhe zotërinj,

Unë, tani, shkurtimisht do të prezantoj punën e Gjykatës gjatë vitit të kaluar gjyqësor. Gjykata pranoi 160 kërkesa, shumica e të cilave (150) janë paraqitur nga parashtrues individualë, ndërsa 10 kërkesa janë paraqitur në Gjykatë nga institucione shtetërore. Individët kryesisht janë ankuar për shkelje të së drejtës së tyre për një gjykim të drejtë, për mbrojtjen e pronës, për të drejtën për të punuar dhe për të ushtruar profesionin.

Nga ana tjetër, kërkesat e paraqitura nga institucionet shtetërore kanë qenë kryesisht të ndërlidhura me pyetjet kushtetuese dhe me amendamentet e propozuara të Kushtetutës. Nga këto 160 raste, Gjykata ka gjykuar 129 raste.

Ndërsa, që nga themelimi i saj në vitin 2009, Gjykata ka regjistruar 1.052 kërkesa individuale dhe kolektive, nga të cilat 968 janë vendosur.

Unë do të përmend vetëm dy raste të vendosura gjatë vitit të kaluar gjyqësor. I pari është aktgjykimi në Rastin KO26/15, që ka të bëjë me vlerësimin e kushtetutshmërisë nga Gjykata të një amendamenti të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, propozuar nga Qeveria dhe referuar në Gjykatë nga Kryetari i Kuvendit.

Me këtë amendament është propozuar të shtohet një nen i ri pas nenit 161 [Tranzicioni i Institucioneve] të Kushtetutës, i cili do të krijonte bazën kushtetuese për krijimin e Dhomave të Specializuara brenda gjyqësorit të rregullt të Republikës së Kosovës, si dhe një Dhomë të Specializuar në kuadër të Gjykatës Kushtetuese, një Ombudsperson të Veçantë dhe një Zyrë të Prokurorit të Specializuar.

Duke u mbështetur në nenet relevante të Kushtetutës, Gjykata duhej të vlerësonte nëse amendamenti i propozuar nuk pakësonte ndonjë nga të drejtat dhe liritë e përcaktuara me Kapitullin II [Të Drejtat dhe Liritë Themelore] të Kushtetutës, dhe, nëse ishte në përputhje me praktikën e saj të vendosur dhe dispozitat kushtetuese që mbrojnë të drejtat dhe liritë e tjera të njeriut.

Gjykata njëzëri vendosi se dispozitat kushtetuese që rregullojnë organizimin dhe strukturën e sistemit gjyqësor lejojnë dhe parashikojnë krijimin e strukturave të reja të veçanta me juridiksion special brenda sistemit ekzistues gjyqësor për t'u marrë me lloje të veçanta të krimeve.

Gjykata konstatoi se krijimi i këtyre strukturave të reja është i ngjashëm me Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

Për më tepër, Gjykata iu referua jurisprudencës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, që konfirmon se neni 6 (1) i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut nuk

mund të lexohet si pengesë për krijimin e gjykatave speciale penale, nëse ato kanë bazë ligjore.

Aktgjykimi i dytë është në rastin KO13/15, i cili ka të bëjë me një amendament në Kushtetutë, i propozuar nga 55 deputetë të Kuvendit, për të shtuar një paragraf në nenin 96 [Ministritë dhe Përfaqësimi i Komuniteteve] të Kushtetutës, ku thuhet: *“Asnjëra nga gjinitë nuk mund të përfaqësohet më pak se 40% në postet e ministrave dhe të zëvendësministrave të Qeverisë së Republikës së Kosovës”*.

Deputetët argumentonin se, deri më tani, gratë në Qeveri nuk ishin të përfaqësuara më shumë se 10 deri në 15 për qind në pozita ministrore, edhe pse raporti gra/burra i popullsisë është 50% me 50%. Në bazë të kësaj, deputetët konsideronin se ishte e nevojshme që të futej kuota gjinore në degën ekzekutive, si një mekanizëm afirmativ për ta ndryshuar atë gjendje.

Pas analizimit të garancive ekzistuese kushtetuese për barazi gjinore, Gjykata në aktgjykimin e saj, gjeti se Kushtetuta përmban garancitë e pranuar ndërkombëtarisht për pjesëmarrje të barabartë të të dy gjinive në jetën publike.

Gjykata vlerësoi më tej se rregullimi kushtetues i kuotave gjinore për pozita ministrore dhe për pozita zëvendësministrore, në praktikë, mund të ketë efektin e diskriminimit gjinor ndaj personave që janë të kualifikuar.

Gjykata Kushtetuese, po ashtu, analizoi kushtetutat e një numri të vendeve demokratike dhe vendimet e disa gjykatave kushtetuese dhe gjeti se nuk është praktikë e zakonshme që me dispozita kushtetuese të rregullohet pjesëmarrja në organe publike nëpërmjet kuotave gjinore. Në fakt, duhet të zbatohet parimi i mundësive të barabarta për gra dhe për burra.

Praktika kushtetuese nuk ka përcaktuar ndonjë formë të diskriminimit pozitiv, ku përparësia jepet në mënyrë automatike dhe të pakushtëzuar në bazë të gjinisë, e duke anashkaluar meritat profesionale.

Zonja dhe zotërinj,

Këto ishin rastet që prezantova, mirëpo secili vendim i marrë tregon se Gjykata i kryen vlerësimet kushtetuese në pajtim me Kushtetutën dhe duke ruajtur parimet e sundimit të ligjit dhe të mbrojtjes së të drejtave të njeriut.

Dëshiroj të theksoj se të gjitha vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë rezultat i punës kolegjiale dhe kolektive të gjyqtarëve dhe të këshilltarëve ligjorë. Në këtë drejtim, është dhënë kontribut i madh nga donatorët në forcimin e kapaciteteve të Gjykatës, nëpërmjet seminareve, punëtorive, trajnimeve dhe vizitave në gjykatat e tjera kushtetuese, në institucionet ndërkombëtare dhe në konferenca të ndryshme brenda dhe jashtë vendit.

Dua të përmend programin e trajnimit për këshilltarët ligjorë të Gjykatës Kushtetuese në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut në Strasburg, që është në zhvillim e sipër. Ky projekt ofron për secilin prej tyre mundësinë që të punojnë për pesë muaj krah për krah me kolegët e tyre, të shkëmbejnë përvojat dhe të marrin pjesë në dëgjimet e Gjykatës së Strasburgut, si dhe në hartimin e raporteve dhe të vendimeve.

Dëshiroj t'u shpreh mirënjohje dhe falënderim të gjithë donatorëve për bashkëpunimin dhe për përkrahjen e tyre.

Të nderuar mysafirë,

Gjykata Kushtetuese ka krijuar një prani të rëndësishme në skenën ndërkombëtare juridike. Gjykata është bërë anëtare e Konferencës Botërore të Drejtësisë Kushtetuese gjatë kësaj periudhe, pas anëtarësimit të Kosovës në Komisionin e Venecias, ku shteti përfaqësohet nga ish-kryetari i Gjykatës, prof. dr. Enver Hasani dhe nga unë.

Aktualisht, Gjykata po vazhdon përpjekjet e saj, me ndihmën e shumë gjykatave të tjera kushtetuese, për t'iu bashkuar Asociacionit Evropian të Gjykatave Kushtetuese dhe Rrethit të Kryetarëve të Gjykatave Kushtetuese Evropiane.

Pavarësisht arritjeve të Gjykatës, është edhe një çështje që dua të ndaj me ju, konkretisht çështjen e moszbatimit të aktgjykimeve të Gjykatës. Edhe pse ato janë pak në numër, kjo është një çështje shqetësuese për mua.

Zbatimi i aktgjykimeve të Gjykatës Kushtetuese është obligim kushtetues për autoritetet kompetente dhe është përgjegjësi e tyre që t'i zbatojnë vendimet, përndryshe ato vazhdojnë të shkelin Kushtetutën dhe të drejtat e qytetarëve.

Pa dyshim, moszbatimi i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese pakëson sundimin e ligjit dhe besimin e popullit të Kosovës në drejtësi.

Vetë Gjykata është ballafaquar me vështirësi të mëdha viteve të fundit dhe si rezultat po punon drejt përmirësimit të menaxhimit, të komunikimit, të kolegjalitetit dhe të transparencës. Unë, si Kryetare e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, jam e përkushtuar që të përmirësoj efikasitetin, efektivitetin dhe kredibilitetin e saj, ta konsolidoj atë dhe ta bëj storie suksesi edhe më tutje. Për të arritur këtë qëllim, unë mbështetem në Gjykatën si tërësi, në gjyqtarët dhe në stafin e saj.

Është koha dhe këtu është vendi i duhur që të lavdëroj tre gjyqtarët jashtëzakonisht të shquar ndërkombëtarë: gjyqtaren Snezhana Botusharova, gjyqtarin Robert Carolan dhe gjyqtarin Almiro Rodrigues. Dua të potencoj pavarësinë, paanshmërinë, integritetin dhe profesionalizmin e tyre të pakontestueshëm. Ata vazhdojnë të japin kontribut të madh për suksesin e institucionit tonë dhe për praktikën gjyqësore të mbështetur në praktikat më të mira dhe në standardet më të larta ndërkombëtare të së drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut dhe të së drejtës ndërkombëtare.

Dëshiroj posaçërisht të përmend dhe të falënderoj për përkushtimin ndaj Gjykatës dhe për punë të palodhshme e profesionale zëvendëskryetarin, gjyqtarin Ivan Čukalović, dhe gjyqtarin Altay Suroy. Respektimi i parimeve të përfshira në Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe i normave të vendimmarrjes kushtetuese është baza që udhëheq punën e tyre. Njëherazi i dëshiroj mirëseardhje të ngrohtë gjyqtarit Bekim Sejdiu.

Dua të lavdëroj gjithashtu edhe këshilltarët tanë ligjorë vendorë dhe ndërkombëtarë për kontributin e tyre të çmueshëm si dhe të falënderoj tërë stafin e Gjykatës për përkushtimin e tyre.

Ju falënderoj për vëmendje!